

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"MIR-CARA" SH.P.K**

**KREUI**  
**EMERTIMI, OBJEKTII VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA**

Neni 1  
EMERTIMI

Duke u bazuar ne: Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", ne nenin 11 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, me vullnetin e tij te lire per te shprehur , sot me date 01.08.2019 ortaku i vetem Z. Nazmi Nezir Cara, i datelindjes 28.09.1982 lindur ne Kurbnesh Mirdite dhe banues ne Tirane, krijon shoqerine me perjegjesi te kufizuar "MIR-CARA" sh.p.k

Neni 2  
SELIA E SHOQERISE

Shoqeria "MIR-CARA" sh.p.k gjendet me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.7, Rruga "Evlija Celebi" Godine Private 3 kateshe, Kati 1, Nr.4. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve (ortakut te vetem).

Neni 3

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Shoqeria mund te krijoje filial ne vende ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 4  
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE (ORTATKUT TE VETEM)

Fusha e autoritetit te ortakeve (ortakut te vetem) dhe perqindja e fitimeve dhe humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri, te percaktuara ne kete statut.



Neni 5  
LIBRI I SHOQËRISË

Për të preçizuar e për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike, si edhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet libri i shoqërisë.

Neni 6  
KONFIDENCIALITETI

Ortakët (ortaku i vetëm) si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 7

Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si: letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj. Duhet të tregojnë lexueshëm: emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët – shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (ose inicialet – sh.p.k), dhe emrin e administratorit

Neni 8  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e: Import – export, shitje e blerje materiale të ndryshme dhe industriale, si dhe shit-blerje skrapi (hekur, alumin, bakër, gizë etj.). Tregtim artikuj të ndryshëm ushqimore dhe industriale. Shërbime dhe riparime të ndryshme, lyerje të objekteve civile etj. Tregti materiale ndërtimi, elektrike, hidraulike, vegla pune, hidrosanitare, materiale pastrimi, detergjente të të gjitha llojeve etj.

Neni 9  
KOHËZGJATJA

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë 10 vjet, me të drejtë të rizgjatet edhe me 20 vjet të tjera me vendim të asamblesë së ortakëve (ortaku i vetëm), por ajo mund të shpërndahet edhe para këtij afati të përcaktuar më sipër me vendim të Asamblesë së Ortakëve, si dhe kur merr fund aktiviteti i saj apo kur shpërndarjen e saj e përcakton ligji.



## **KREU II**

Neni 10

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

Kapitali fillestar i shoqerise private "MIR-CARA" sh.p.k do te jete 1.000 (njemije) leke. Kapitali eshte' 100% nga kuotat e ortakut te vetem, e ndare ne 1 kuote me nga 1.000 leke secila kuote. Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Neni 11

### **LENIA DHE TRANSFERIMII PJESEVE TE KAPITALIT**

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete, nese Asambleja e miraton.

Neni 12

Asambleja e Ortakeve miraton llogarite, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar, merr vendim per ndryshimet qe mund te pesoje statute, per ndryshimin e mases se kapitalit themeltar dhe shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter, per punesimin e punonjesve dhe pagat, si dhe probleme te tjera te lidhura me punesimin ne zbatim te legjislacionit shqiptar, etj. Vendimet e Asamblese se Ortakeve evidentohen ne nje rregister.

## **KREU III**

Neni 13 ORGANET  
DREJTUESE

Organi vendimor i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "MIR-CARA" sh.p.k eshte Asambleja e Ortakeve (Ortaku i vetem) te shoqerise, e cila zgjedh administratoret qe do te hyjne ne marredhenie me te tretet.

Neni 14

Shoqeria drejtohet nga administrator ne funksion qe kryhet nga Z. Nazmi Cara te cilit i atribuohen te gjitha kompetencat, pervec atyre te cilat ligji ia njeh shprehimisht Asamblese se Ortakeve. Administratori qendron ne detyre nga data 01.08.2019 per nje periudhe 5-vjecare deri me 31.07.2024, me te drejte rizgjedhjeje.



## **KREU IV**

### **LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI**

Neni 15

Shoqëria është e detyruar të mbajë përvèç dokumentacionit kontabël ose librave të tjera edhe: Librin e shoqërisë në të cilin shënohen; Emrat e Ortakëve, kapitali themeltar, si dhe vendimet e Asamblesë.

Neni 16

### **PUNËSIMET NË SHOQËRI**

Për punonjësit që do të punësohen, marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe punëmarrësve do të rregullohen me kontratën e punës në përputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punës.

Neni 17

Shoqëria merr përsipër të derdhë rregullisht të gjitha detyrimet, gjithashtu dhe kontributet për sigurimin e të punësuarve të saj në organet kompetente sipas ligjit.

Neni 18

### **BILANCI**

Shoqëria është e detyruar të dorëzojë bilancin dhe pasqyrat financiare brenda afateve të caktuara në ligjin për kontabilitetin.

Neni 19

### **SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI**

Shoqëria mbaron me vendim të Asamblesë së Ortakëve ose kur ka prishje të parakohëshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 20

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakëve cakton një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre. Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakëve

vendos mbi bilancin përfundimtar financier dhe mbi mbylljen e proçesit të likuidimit. Pas pagimit të likuidatorëve, Asambleja mban pjesën e mbetur të kapitalit.

Neni 21  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërsë ose gjatë periudhës së likuidimit, do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente.

Neni 22  
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky statut u hartua në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjtë ligjore. Përsa nuk është shprehur në këtë statut, do të bazohet ligji “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë që është në fuqi.

**ORTAKU I VETËM**

**NAZMI CARA**

